



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 50 Akti

Nr. 40 Vendimi

Tiranë, më 17.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | | |
|----------|----------|----------|
| Olsi | Komici | Kryesues |
| Lulzim | Hamitaj | Relator |
| Brunilda | Bekteshi | Anëtare |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në Tiranë, më datë 10 korrik 2018, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Admir S. Thanza, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë, përfaqësuar, me deklaram në seancë, nga Theodhori Sollaku, avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin e tij, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit Admir Thanza, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 10.07.2018 kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Z. Admir Thanza është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar si “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”.*

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë anëtar i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtuar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit”, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si “Komisioni”).

Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 3, pasi administroi dhe studioi tri raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 14.12.2017, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, z. Olsi Komici. Gjithashtu, në këtë

mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

Më datë 08.05.2018, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Admir Thanza, për të tria kriteret e rivlerësimit, të parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes.

Më datë 28.05.2018, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike; (iii) për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të KPrA-së; (iv) përbërjen e trupit gjykues, me ftesën që duhej të deklaronte nëse kishte konflikt interesi me ndonjërin nga anëtarët e trupit.

Më datë 22.06.2018, subjekti i rivlerësimit, – pasi i kishte kërkuar Komisionit kohë shtesë dhe i ishte akorduar një shtyrje afati prej dhjetë ditësh, për t'i mundësuar gjetjen e dokumentacionit të nevojshëm për mbrojtjen e tij, – dërgoi shpjegimet e tij, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

Më datë 28.06.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3 vendosi të ftojë, – përmes postës elektronike, – subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, fillimisht u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 4 korrik 2018. Por, pasi subjekti i rivlerësimit u shpreh se koha midis njoftimit të bërë dhe datës së seancës dëgjimore nuk ishte e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij, trupi gjykues vendosi të linte më shumë kohë në dispozicion të subjektit të rivlerësimit dhe të ricaktojë datën 10 korrik 2016, për zhvillimin e seancës dëgjimore, duke i bërë atij njoftimin formal.

Më datë 10.07.2018 u zhvillua seanca dëgjimore ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent, së bashku me përfaqësuesin e tij ligjor.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Admir Thanza, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma. Në fillim të seancës dëgjimore, të datës 10 korrik 2018, pasi u verifikua prezenca e subjektit të rivlerësimit, e përfaqësuesit të tij ligjor, si dhe e vëzhguesit ndërkombëtar, përpara sesa të merrte fjalën relatori, ndërhyri avokat Sollaku, i cili kërkoi sqarime përse ishte ndryshuar kryesuesja e paracaktuar me kryesuesin aktual të trupit gjykues – duke e konsideruar të mirëqenë këtë fakt. Atij iu përgjigj relatori, duke i shpjeguar se nëpërmjet njoftimeve të kryera nga Komisioni, nuk rezulton të jetë bërë ndonjëherë specifikimi/cilësimi i pozicionit të anëtarëve të këtij trupi gjykues. Nëse kjo do të kishte ndodhur, mund të kishte qenë thjesht ndonjë lapsus, por qëndron fakti se, që

prej mbledhjes së parë, të bërë pas hedhjes së shortit, kryesuesi i këtij trupi është caktuar dhe ka vijuar të jetë z. Komici, pa u bërë asnjë ndryshim. Këtë fakt e konfirmoi edhe vëzhguesi ndërkombëtar.

Në sajë të sa më lart, vlerësohet e dobishme të sqarohet dhe të konfirmohet edhe një herë që kryesuesi i trupit që kreu rivlerësimin e z. Thanza, që nga nisja e hetimit administrativ ka qenë z. Olsi Komici. Ndoshta përfaqësuesi ligjor i z. Thanza ka aluduar mbi një ndryshim të kryesuesit, duke keqkuptuar/keqinterpretuar faktin që në njoftimin e bërë nga Komisioni, për njohjen me anëtarët e trupit, e para në listë ishte znj. Bekteshi, por pa pasur asnjë citim cilësimi për asnjë nga të tre anëtarët, në lidhje me pozicionimin e tyre në këtë trup gjykues.

Pas kësaj, e mori fjalën relatori i çështjes, i cili paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë hetimeve të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit, si nëpërmjet shqyrtimit, edhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar.

Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, z. Admir Thanza shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse të detajuara lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Po ashtu, e mori fjalën edhe përfaqësuesi i tij ligjor, i cili u ndal vetëm mbi vlerësimin e precedentëve penalë dhe mbi konkludimin e raportit të DSIK-së mbi papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, për të vijuar në detyrën e tij. Më pas, subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit depozitoi sërish pranë Komisionit parashtrimet e tij me shkrim, si dhe disa dokumente mbështetëse, në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ. Në fund të seancës dëgjimore, z. Admir Thanza shprehu qëndrimin e tij përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion, ai kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.

Seanca dëgjimore e datës 10.07.2018 u ndërpre, për të rifilluar më datë 17.07.2018, për shpalljen e vendimit.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin, z. Admir Thanza, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Admir Thanza, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI; c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; ç) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; d) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, më datë 05.06.2018, si dhe në seancë dëgjimore - për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; dh) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur, e) faktet e njohura botërisht.

Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar me shkresën nr. (***) prot., datë 17.11.2017, raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Admir Thanza, ku konstatohet se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

Mbi asetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016

1- Apartament banimi, me sipërfaqe 136 m², në Rr. “(*)”, Shkodër.**

Ky apartament rezulton të jetë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, si në Deklaratën-Vetting, edhe në deklaratën e vitit 2003, me vlerë 3.000.000 lekë dhe me pronësi 25 %. Por, nga hetimi administrativ i kryer është konstatuar se në deklaratën e vitit 2003 rezultojnë dy faqe me nr. 4, që i përkasin po të njëjtit formular, “A1”. Të dyja fletët janë të datuara në pjesën e sipërme djathtas të tyre “31.12.2003” (datë që referonte periudhën deri kur ishte bërë deklarimi). Por, te njëra prej tyre, ka dy ndryshime: në pjesën e përshkrimit të burimeve është shtuar “*vlera e blerjes 1.2 milion lekë rikonstruktiv (rregullim) 1.8 milion lekë*” dhe, në pjesën e fundit të saj, majtas, është shënuar data 29.01.2005.

Gjithashtu, nga subjekti i rivlerësimit janë deklaruar si burim të ardhurash për blerjen e këtij apartamenti – e bërë më datë 06.04.2000¹ – përfitimet e realizuara nga shitja e dy apartamenteve të tjera në Shkodër, e kryer po në vitin 2000, por në datën 16 nëntor.

Nga një analizë e të dhënave të mësipërme, evidentohen mospërputhje dhe pasaktësi të ndryshme, dhe konkretisht:

a - çmimi i apartamentit, i deklaruar nga subjekti në vlerën 3.000.000 lekë, nuk përputhet me atë të pasqyruar në kontratën e shitblerjes, që është 1.200.000 lekë;

b - në deklarimin e dorëzuar në datën 17.03.2004 ka një pamjaftueshmëri, pasi mungon deklarimi i garazhit, të blerë bashkë me apartamentin në fjalë dhe më pas të deklaruar (vetëm) në vetting;

c - çmimi i pasqyruar në kontratë (prej 1.200.000 lekësh) nuk përputhet me çmimin real – të një apartamenti të ri – pasi ai rezulton të jetë disa herë më i vogël, në krahasim me çmimin mesatar të tregut në atë vit, në qytetin e Shkodrës²;

d - shtesa/modifikimi e bërë në njërin nga formularët “A1”, faqe nr. 4 (tek ai që mban dy data) – në lidhje me shtesën e garazhit, si dhe përshkrimi i një çmimi të ndryshëm të blerjes dhe të shpenzimeve për rregullimet e pretenduara të apartamentit në fjalë, – ngjajnë se janë bërë jo në përputhje me procedurat dhe udhëzimet e institucionit përkatës³, pasi mungon një procesverbal që të pasqyrojë një veprim ndërhyrjeje apo sqarues, në një dosje të administruar;

e - shuma e cituar për rregullimet/punimet e pretenduara nuk rezulton që të jetë provuar me dokumentacion përkatës, veç faktit që apartamenti rezulton të jetë blerë i ri dhe, për rrjedhojë, nuk duket shumë bindës shpjegimi, sipas të cilit janë kryer punime “rregullimi” brenda të njëjtit vit të blerjes në këtë apartament;

f - konstatohet një mospërputhje mbi burimin financiar për blerjen e këtij apartamenti, pasi të ardhurat nga shitja e kryer më datë 16.11.2000 – të deklaruara nga subjekti si burim financiar për

¹ Sipas kontratës së shitblerjes, nr. (***) rep., nr(***)kol., datë 06.04.2000, “Akt shitblerjeje pasurie të paluajtshme, apartament banimi”, me shitës F. C., në cilësinë e administratorit të firmës ndërtuese “(***)” sh.p.k. dhe blerës S. Th., Admir Thanza, E. A. dhe F. Th., me çmim 1.200.000 lekë.

² Kjo rezulton nga shkresa/përgjigje e ZVRPP-së Shkodër, e datës 16.04.2018, nr. (***)prot., nëpërmjet së cilës i komunikon Komisionit çmimin mesatar të pasurive të paluajtshme në qytetin e Shkodrës.

³ ILDKP-së (së atëhershme).

këtë blerje – nuk mund të përdroreshin për pagesën e blerjes së realizuar më datë 06.04.2000, pasi shitja është kryer në nëntor të vitit 2000 dhe, për rrjedhojë, nuk përputhet periudha kohore, për të pasur një mundësi likuiditeti në momentin e blerjes në fjalë.

1.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve mbi këtë pasuri.

Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përgjigjeve dhe sqarimeve që ka dërguar me anë të postës elektronike⁴, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të tij, të gjata dhe të detajuara, të dhëna në seancën dëgjimore të datës 10.07.2018, nuk ka arritur të provojë qëndrimin e tij në mënyrë bindëse.

Subjekti i rivlerësimit mbrojti tezën se apartamenti në fjalë është blerë në stadin “karabina” dhe, me këtë arsye, mund të shpjegohej fakti që pas blerjes ai ka shpenzuar, veç çmimit të kontratës, edhe një shifër prej 1.5 herë më shumë sesa vetë çmimi, për të kryer punimet e nisura pas datës 16 nëntor 2000, për përfundimin e ndërtimit/plotësimit të tij, duke shpenzuar të ardhurat e përfituara nga shitja e dy apartamenteve në po atë datë (16.11.2000).

Sipas tij, të gjitha pagesat janë kryer me të ardhura të ligjshme dhe janë deklaruar me shumë korrektësi edhe disa shifra të shpenzuara, që edhe mund të mos ishin deklaruar, si p.sh. 1.8 milion lekë për punimet e kryera në vitin 2000, të ky apartament.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit e konsideron normal një çmim prej 1.2 milion lekësh për një apartament (sipas tij karabina) prej 140 m², me katër dhoma, dy ballkone dhe dy banjë, plus një garazh prej 18 m².

Në lidhje me prezencën e dy formularëve “A1” në deklaratën e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit nuk e përjashton mundësinë që ta ketë bërë ai modifikimin, por nuk e kujton këtë fakt, për shkak të distancës së gjatë kohore. Në çdo rast, thotë ai, mund të ketë vepruar sipas kërkesave apo udhëzimeve që mund të kenë ardhur nga institucioni i ILDKPKI-së.

1.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Në lidhje me blerjen e apartamentit në stadin karabina, konstatohet se arsyetimi, shpjegimi dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, si edhe teza e tij e sipërpërmbledhur, nuk vlerësohen bindëse nga Komisioni, kryesisht sepse nuk rezultojnë bindës fakti që apartamenti në fjalë të ketë qenë realisht karabina në momentin e shitblerjes. Ky deduktiv mbështetet, të paktën, mbi dy rrethana formale, si dhe në dy elemente faktike që, me një analizë të thjeshtë logjike, të çojnë në atë përfundim, dhe konkretisht:

- a- Së pari, bëhet fjalë për shitblerjen e një apartamenti që është pjesë përbërëse e një

⁴Referojuni përgjigjeve të pyetësorëve; parashtrimeve/prapësimeve të nisura në Komision pas kalimit të barrës së provës, si dhe shpjegimeve verbale të dhëna në seancën dëgjimore.

- pallati/godine, që përmban në vetvete një numër të caktuar apartamentesh, regjistrimi⁵ në ZRVPP dhe shitja definitive e të cilave mund të kryhet vetëm pasi pallati të jetë kolauduar si një i tërë, pra si një grup/bashki njësisish banimi⁶.
- b- Së dyti, është fakt i njohur që akti i kolaudimit mund të kryhet vetëm pasi të jetë përfunduar tërësisht ndërtimi i pallatit/godinës dhe ai të jetë kompletuar me montimin dhe mirëfunksionimin e të gjitha shërbimeve të përbashkëta, si ashensor, shkallë, pompa uji, shërbime furnizimi me energji elektrike, uji etj. Dhe të gjitha këto montohen, sistemohen dhe kolaudoohen, pasi kanë përfunduar punimet e muraturës që bëjnë kalimin nga stadi karabina, në apartamente të muruara, shtruara dhe të instaluar, me dyer dhe dritare të montuara⁷.
 - c- Së treti, në kontratën e shitblerjes së datës 06.04.2000 nuk përmendet fakti (i pretenduar) se apartamenti – objekt shitjeje – ishte në gjendje karabina. Përkundrazi aty deklarohet se sendi mund të gëzohet nga blerësit, mund të regjistrohet menjëherë në emër të tyre, si dhe që është i lirë nga çdo barrë dhe hipotekë.
 - d- Së katërti, duke u rikthyer te kontratat e shitblerjeve të kryera më datë 16.11.2000, duhet të theksohet fakti që shuma totale e të dyja shitjeve ka sjellë në disponibilitetin (e vonuar) e subjektit të rivlerësimit vetëm shumën prej një milion lekësh (600 mijë, plus 400 mijë), ndërsa shpenzimi që ai ka pretenduar se është kryer me këtë burim financiar rezulton të jetë 1.8 milion lekë. Pra, edhe në këtë rast do të kishim një pjesë të shpenzimit të kryer, prej 800 mijë lekësh, të pajustificuar nga burime të ligjshme.

Për sa i përket çmimit të blerjes së pasurisë në fjalë, Komisioni gjykon se, bazuar në sa është përgjigjur ZVRPP Shkodër, më datë 16.04.2018, edhe çmimi i deklaruar, 3 milionë lekë, për blerjen e apartamentit dhe garazhit, rezulton të ketë qenë më pak sesa gjysma e çmimit të tregut të lirë, në atë vit dhe, për rrjedhojë, çmimi konkretisht i aplikuar dhe shënuar në kontratë (1.2 milionë lekë) mund të jetë vetëm 1/5-ta ose 1/4-ta e çmimit të referuar nga institucioni i paracituar.

Në lidhje me sa ngre në diskutim subjekti i rivlerësimit, se çmimi i referencës nuk është i detyrueshëm, por vlen vetëm për pagesat e taksave nga ndërtuesit, duhet thënë që është i vërtetë. Por, duhet të përmendet edhe fakti se nga subjekti nuk është provuar e kundërta, pra që çmimi me të cilin ai e ka blerë këtë pasuri është në nivel mesatar me atë të tregut të lirë. Gjithsesi, çmimi i referencës mund të mos ketë qenë dhe të mos jetë i detyrueshëm, dhe askush nuk e ka pretenduar këtë, por analiza logjike kërkon sigurisht një arsye bindëse që një investitor/ndërtues, – që ka për qëllim realizimin e sa më shumë fitimeve nga investimet e veta, – të shesë një apartament dhe garazh me një çmim disa herë më të vogël se ai i referencës (duke konkretizuar një veprim juridik në kuadrin e një trajtimi preferencial), dhe njëkohësisht të paguajë taksat në bazë të çmimit të referencës, pasi ky i fundit është një detyrim ligjor (siç e ka cituar edhe vetë subjekti), ndërsa

⁵ Regjistrimi i apartamentit në fjalë është kryer më datë 17.02.2000, me nr. pronësie (***).

⁶ Për më shumë mund t'i referoheni ligjit nr. 8045/1998, që ka hyrë në fuqi pikërisht dy vite para se të kryhej shitblerja në fjalë.

⁷ Për më shumë detaje legjislative, që pengonin një kolaudim dhe një shitje definitive në gjendje karabina, mund t'i referoheni ligjit nr. 4902/1998.

çmimi i aplikuar në kontratë mbetet në zgjedhjen e palëve.

Për sa i përket gjetjes së faqes nr. 4, te formulari “A1” i dyfishtë, në deklarin e vitit 2003, – të dorëzuar më 17.03.2004, – rezulton disi e komplikuar të konsiderohet i mjaftueshëm dhe bindës shpjegimi se ishte detyrim i ILDKPKI-së të verifikonte rregullsinë e dokumentacionit, pasi jemi përballë dy fletëve me të njëjtin numër, të të njëjtit deklarin, të të njëjtit vit, të dyja të firmosura nga subjekti i rivlerësimit. Te njëra prej tyre rezulton e shënuar edhe data 29.01.2005, veç asaj 31.12.003 që është te te dyja. Ky mund edhe të ketë qenë një modifikim shtesë, i bërë në sajë të shpjegimeve të kërkuara nga institucioni kompetent, por në këtë rast do të duhej të kishte në dosje edhe një procesverbal të ILDKPKI-së, që do të formalizonte modifikimet e bëra në formularin “A1”, dhe do të pasqyronte më gjerë shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni nuk ka konstatuar asnjë dokument që mund të shpjegonte apo justifikonte prezencën e dy faqeve nr. 4, të formularit “A1”, – por njëra me ndryshime dhe shtesa në krahasim me tjetrën, – në dosjen e subjektit të rivlerësimit. Subjekti nuk kërkoi shpjegime tek institucioni në fjalë për të hedhur dritë mbi këtë rrethanë, për të provuar të kundërtën, dhe as nuk mohoi që të dy formularët “A1” të jenë firmosur prej tij.

Gjithsesi, në konkluzion të arsyetimeve të mësipërme, Komisioni arrin në përfundimin se, nga çdo lloj këndvështrimi që mund të analizohet dhe vlerësohet kjo pasuri dhe ky deklarin, rezulton e provuar ekzistenca e deklarin të pamjaftueshëm, të paplotë, të pasaktë, në përputhje me ligjin, të rrethanave dhe shpjegimeve kontradiktore dhe jo bindëse; e mungesës së disponibilitetit – në momentin e blerjes së kësaj pasurie, – të burimit financiar me prejardhje nga shitja e dy apartamenteve, të deklarin si të përdorur për pagesën e blerjes së apartamentit në fjalë. Këto veprime rezultojnë që të jenë kryer në mosrespektim të ligjit nr. 9049/2003 dhe të ndryshimeve të tij, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe që, për rrjedhojë, na çojnë në aplikimin e nenit 61, pika 3, të po këtij ligji.

2- Apartament banimi, me sipërfaqe 113 m², Rr. “(*)”, Tiranë.**

Kjo pasuri, ish-në pronësinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, rezulton e deklarin në deklarin të vitit 2003 “*me vlerë 4 milion lekë*”, nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. E. A., – person i lidhur me të, sipas kuptimit të pikës 13 të neni 3 të ligjit nr. 84/2016.

Nga hetimi administrativ u konstatua se në kontratën e shitblerjes, me nr. (***)rep. dhe nr. (***)kol., të datës 3 korrik 2003 – me palë shitëse z. H. K. dhe 13 bashkëtrashëgimtarë të tjerë dhe palë blerëse znj. E. A., – për apartamentin me sipërfaqe 113 m², të ndodhur në Selitë, Tiranë, çmimi i blerjes ishte 1.950.000 lekë.

Për rrjedhojë ka rezultuar se çmimi i apartamentit të sipërcituar, i deklarin në vlerën prej 4.000.000 lekësh në deklarin të vitit 2003, nuk përputhet me atë të pasqyruar në kontratën e shitblerjes, që është 1.950.000 lekë.

2.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve mbi këtë pasuri

Në lidhje me problematikat e konstatuara mbi këtë pronësi, subjekti i rivlerësimit, si nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit, edhe në shpjegimet e dhëna pas njoftimit të rezultateve të hetimit dhe të barrës së provës, ka deklaruar se, ashtu si edhe për apartamentin në Rr. “(***)” në Shkodër, edhe për këtë pasuri deklarimi është bërë për një vlerë më të madhe sesa çmimi i shitjes, pasi aty ishte përfshirë edhe shuma e shpenzuar për punimet e kryera në të, – për një vlerë mbi dyfishin e çmimit të deklaruar, – pa dhënë asnjë provë mbi kryerjen e punimeve në këtë apartament.

2.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, mbështetur në deklaratat e subjektit të rivlerësimit në raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike, sipas pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, provat shkresore të administruara sipas neneve 49 dhe 50 të po këtij ligji, deklaratat e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, shpjegimet dhe provat e dërguara, si dhe ato të argumentuara në seancën dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në sajë të fakteve të pasqyruara në paragrafët e mësipërm, në lidhje me deklaratat dhe veprimet juridike të kryera mbi pasurinë objekt shqyrtimi, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 113 m², në rrugën “(***)”, Tiranë, – të deklaruar të ndryshëm nga sa rezulton në kontratën e datës 03.07.2003.

Shpjegimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit konsiderohet jo bindës për faktin e thjeshtë që, sipas tezës së tij, shpenzimet e punimeve riparuese në këto apartamente kanë qenë më të larta se vetë çmimi i blerjes së tij. Në realitet, dyshohet se çmimi i pasqyruar në kontratë ka qenë fiktiv, me qëllim shmangien e një tarife tatimore më të lartë, që do të duhej të aplikohet nëse do të deklarohet çmimi i plotë. Është fakt i njohur, që deri në çmimin prej 2 milionë lekësh, tarifa ishte minimale dhe pasi çmimi kapërcente këtë cak, tarifa rritej ndjeshëm. Përgjithësisht, për të evituar pikërisht aplikimin e një tarife më të lartë, shpesh palët kontraktuese binin dakord që formalisht në kontratë të pasqyronin një çmim me vlerë më të ulët se 2 milionë lekë, pra të ndryshëm nga ai real. Ky fenomen është konstatuar edhe në raste të tjera dhe i njohur gjerësisht. Pra, ka dyshime të arsyeshme që, në rastin konkret, të mos jenë kryer punime riparimi/rregullimi menjëherë pas blerjes në apartamentin në fjalë, të paktën jo në shumën e pretenduar, dhe që çmimi real të jetë ai i deklaruar në ILDKPKI dhe çmimi në kontratën e shitblerjes të jetë fiktiv.

Në vijim të arsyeve të mësipërme, Komisioni arrin në përfundimin se nga analiza dhe vlerësimi i veprimeve juridike dhe deklaratave që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur më të kanë dhënë në lidhje me këtë pasuri, rezulton e provuar ekzistenca ose e pasqyrimin të një çmimi fiktiv në kontratën e shitblerjes, ose e një deklarimi të pamjaftueshëm në ILDKPKI, pasi çmimi është pasqyruar mbi dyfishin e atij që rezulton nga kontrata, pa provuar kryerjen e shpenzimeve për punimet e pretenduara. Në çdo rast, secili nga këto veprime rezulton në mosrespektim të ligjit

nr. 9049/2003 dhe të ndryshimeve të tij, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe që, për rrjedhojë, çon në aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

3- Garazh sip. 23.4 m², ndodhur në Rr. “(*)”, Tiranë.**

Pasuria e lartpërmendur, me nr. (***), vol. (***), fq. (***), ZK (***), Tiranë, rezulton e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit vetëm në Deklaratën-Vetting. Pasuri e blerë nga bashkëshortja e tij, znj. E. A., me kontratën nr. (***)rep., nr. (***) kol., datë 18.01.2007, me çmim 400.000 lekë.

Nga hetimi administrativ, rezultoi se kjo pasuri asnjëherë nuk ishte deklaruar në deklaratimet periodike të pasurisë pranë ILDKPKI-së. Pra, garazhi në fjalë nuk ka qenë i deklaruar as kur ai është blerë, në deklaratën e vitit 2007, dhe as në deklaratat e viteve të mëpasshme, 2008 - 2016, periudhë gjatë së cilës kjo pronë është poseduar.

Kjo mungesë deklarimi e garazhit është konstatuar nga ana ILDKPKI-së si fshehje pasurie dhe si deklarim i rremë⁸.

Në lidhje me mosdeklarimin e garazhit, subjekti i rivlerësimit e ka pranuar atë dhe është shprehur se ka qenë një harresë.

Komisioni vlerëson se mosdeklarimet e sipërcituara, në lidhje me pasurinë garazh, përbëjnë veprime dhe qëndrime të subjektit të rivlerësimit që rezultojnë në mosrespektim të ligjit nr. 9049/2003 dhe të ndryshimeve të tij, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe, si të tilla, të çojnë në aplikimin e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

4- Rezultatet e analizës financiare

Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka kryer analizën financiare, duke u bazuar në sa më poshtë:

- a-** deklaratimet e bëra ndër vite nga ana e subjektit të rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së;
- b-** provat shkresore të administruara nga ana e ILDKPKI-së;
- c-** dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit;
- d-** deklaratimet e bëra nga ana e subjektit të rivlerësimit, përmes postës elektronike, gjatë hetimit administrativ të kryer nga ana e KPK-së;
- e-** provat shkresore të administruara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nga institucione publike dhe private;
- f-** analizën financiare të bërë nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
- g-** çdo dokument që përbën mjet prove sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

Duke bërë një përmbledhje të përgjithshme të përlllogaritjeve në bazë të të ardhurave neto të siguruar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga aktiviteti profesional i bashkëshortes së tij, rezultoi

⁸ Shih faqen nr. 8 të relacionit të ILDKPKI-së.

se në disa vite bilanci është negativ. Pra, përkatësisht në periudhën 1992 - 2003⁹, si dhe në vitet 2004, 2005, 2008 dhe 2009, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e kryera dhe njëkohësisht për të mundur kursimet e realizuara, sipas deklaratave periodike, sipas shpjegimeve që ai ka dhënë në përgjigje të pyetësorëve, si dhe në bazë të të dhënave bankare.

Gjithashtu, është konstatuar se të dhënat e deklaruara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit shpesh nuk përkonin me përmbajtjen e dokumentacionit të administruar nga Komisioni dhe, për rrjedhojë, midis rezultateve që dalin nga përpunimi i deklaratimeve të subjektit dhe rezultateve të arritura nga lëvrimi i shifrave të dokumentuara, rezultojnë një diferencë e konsiderueshme. Rezultatet e analizës financiare të të ardhurave, pasurive, detyrimeve dhe shpenzimeve për çdo vit, përgjatë periudhës 1992 - 2003 dhe viteve nga 2004 deri në 2016, janë pasqyruar në tabelën përmbledhëse që vijon:

| Periudha/Viti | Të ardhurat sipas vërtetimeve | Pasuri - Detyrime + Shpenzime | Diferenca |
|---------------|-------------------------------|-------------------------------|------------|
| 1992-2003 | 16.632.180 | 19.360.045 | -2.727.865 |
| 2004 | 2.211.292 | 2.580.988 | -369.696 |
| 2005 | 3.098.264 | 3.946.503 | -848.239 |
| 2006 | 2.271.449 | 1.102.282 | 1.169.167 |
| 2007 | 3.992.748 | 2.836.920 | 1.155.827 |
| 2008 | 2.781.567 | 3.169.886 | -388.319 |
| 2009 | 9.942.303 | 12.740.727 | -2.798.424 |
| 2010 | 4.650.288 | 3.584.771 | 1.065.517 |
| 2011 | 4.193.976 | 3.409.512 | 784.464 |
| 2012 | 4.481.382 | 1.432.047 | 3.049.335 |
| 2013 | 4.569.590 | 4.275.826 | 293.764 |
| 2014 | 5.025.244 | 3.843.180 | 1.182.064 |
| 2015 | 4.966.458 | 4.548.770 | 417.688 |
| 2016 | 4.611.953 | 4.634.746 | -22.793 |

⁹ Periudha 1992-2002 fillimisht nuk ishte përlogaritur në analizën financiare të kryer nga Komisioni, por u përlogarit me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, si dhe duke përdorur edhe të dhënat që ai paraqiti, të pasqyruara në analizën financiare të përpiluar nga ekspertët e zgjedhur prej tij dhe të administruar në dosje.

Periudha 1992 - 2003, sipas të dhënave që ka përcjellë te Komisioni vetë subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet analizës financiare që kanë kryer ekspertët ekonomikë, pra nga auditi i ngarkuar prej tij, rezultojnë me bilanc negativ prej - 2.727.865 lekësh. Edhe përgjatë periudhës 2004 - 2016, rezultojnë me bilanc negativ 4 vite, përgjatë të cilave rezultojnë të jenë kryer shpenzime me burime financiare të pajustificuara, në shumën prej - 4.427.471 lekësh.

Ndërsa, nga përlllogaritja e zërave në total për periudhën 2003 - 2016, rezultojnë një diferencë e theksuar midis deklaramëve të bëra nga subjekti dhe të dhënave që u konstatuan përgjatë analizës së dokumentacionit të administruar nga Komisioni. Kjo diferencë është pasqyruar në tabelën përmbledhëse si më poshtë:

| Nr. | ANALIZA FINANCIARE | Sipas deklaramëve | Sipas dokumenteve |
|-----|--------------------------------|-------------------|-------------------|
| 1 | Të ardhurat totale (familjare) | 75.625.609 | 58.789.113 |
| 2 | Pasuritë | 41.544.543 | 38.476.843 |
| 3 | Detyrimet | 3.240.980 | 3.240.980 |
| 4 | Pasuria neto | 38.303.563 | 35.235.863 |
| 5 | Shpenzimet | 13.615.797 | 26.240.217 |
| | Diferenca | 23.706.249 | -2.686.967 |

Gjithashtu, duhet theksuar se, në sajë të sa më lart, janë konstatuar një sërë deklaramesh periodike të pamjaftueshme, pasi ato kanë pasqyruar të dhëna dhe kryesisht të ardhura, të ndryshme nga ato që janë evidentuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni. Në deklaratën periodike të vitit 2006 nuk janë deklaruar të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, gjë që është pranuar edhe nga subjekti. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, rezultoi se në vitin 2006 znj. E. A. kishte pasur në aktivitetin e saj një qarkullim vjetor prej 3.200.000 lekësh dhe një fitim neto prej 1.245.979 lekësh.

4.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me analizën financiare

Në lidhje me të dhënat e lëvruara në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit, – nëpërmjet shpjegimeve të dhëna, analizës financiare të kryer nga auditi i zgjedhur prej tij, si dhe provave të tij të përcjella në Komision, lidhur me rezultatet e hetimit që i ishin komunikuar, por edhe nëpërmjet argumentimeve të hollësishme dhe të gjata që ai bëri në seancën dëgjimore, – paraqiti disa vërejtje të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, në lidhje me përlllogaritjen e fitimeve të realizuara përgjatë viteve 1992 - 2003, në bazë të analizës financiare të paraqitur nga auditi i zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit; mbi shpenzimet e disa udhëtimeve, që sipas tij ishin zyrtare dhe ishin kryer me shpenzime institucionale dhe jo familjare, duke kërkuar mos llogaritjen e tyre në analizën financiare; pranoi mosdeklarimin e të ardhurave të realizuara nga bashkëshortja e tij në vitin 2006, por e konsideron atë si një harresë dhe një gabim material dhe jo një deklaram të pasaktë apo i paplotë; kundërshtoi metodologjinë e përlllogaritjes së shpenzimeve jetike, pasi sipas tij ato janë përlllogaritur më të larta nga ato reale, duke e vënë theksin mbi disa vite që ka pasur

disa shpenzime të mbuluara nga institucionet (si transport dhe celularë), si dhe mbi periudhën që familja e tij rezulton të ketë jetuar në qytetin e Shkodrës, ku kostoja e jetesës është më e ulët se ajo e qytetit të Tiranës, ku ai ka jetuar më pas dhe vijon të jetojë; pohon që mospërputhjet e shumave të fituara nga bashkëshortja e tij ndër vite, me ato që janë deklaruar periodikisht, shpjegohen me faktin se ai mund të ketë deklaruar shifrat bruto, – pra xhiron vjetore, – dhe jo fitimet neto, pasi nuk e ka specifikuar nëse ato ishin neto apo bruto, por thjesht “të ardhurat”, pa sjellë asnjë pasojë të përligjjes së pasurisë me të ardhura të paligjshme. Kjo situatë, sipas tij, është edhe pasojë e moskonstatimit ndër vite nga ana e ILDKPKI-së të problematikave të tilla, që kishte për detyrë t’i vërente dhe t’ia komunikonte ato subjektit brenda vitit kalendarik

4.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me rezultatet e analizës financiare

Për sa më lart, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit, duke i pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve të tij bindëse¹⁰ në rezultatet financiare të viteve respektive.

Në lidhje me përllogaritjen e koston së jetesës, Komisioni e vlerëson të pabazuar kundërshtimin dhe pretendimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pasi rezulton të jetë aplikuar një kosto jetese minimale dhe standarde në rang kombëtar, pra nuk merr parasysh ndryshimin midis qyteteve, për sa kohë ajo pasqyron minimalen e mbijetesës në zonat më pak të zhvilluara të vendit. Pra, nëse do të aplikoheshin parametra të diferencuar, sigurisht që për banorët e qyteteve kryesore – përfshirë këtu edhe Shkodrën – do të përllogaritej një shumë vjetore sigurisht më e lartë sesa ajo shifër që është përllogaritur në rastin konkret për shpenzimet jetike minimale (*440 lekë në ditë për një person, ose rreth 3.5 euro në ditë për një person deri në vitin 2007 dhe 352 lekë ose më pak se 3 euro në ditë për një person deri në vitin 2016*). Pra, nuk vlerësohet bindës ky lloj argumentimi.

Gjithashtu, vlerësohet se rimbursimi/mbulimi i mundshëm i shpenzimeve për transportin dhe shërbimet telefonike, presupozon se ai i shtrin efektet mbi shpenzimet ekstra, të kryera në shifra më të larta, pikërisht, për shkak të detyrës, dhe jo për mbulimin e kostove jetike minimale për mbijetesë, në shifrën e lartpërmendur, rreth 3 euro në ditë.

Nëse do të përllogariteshin me shifra më reale dhe të segmentuara për çdo zë: ushqimi, faturat e energjisë elektrike, të ujit, të shërbimeve televizive, interneti, pastrimi dhe mirëmbajtja e banesave dhe e autovecurave, siguracionet e ndryshme, argëttimeve të mundshme (si p.sh., frekuentimi i restoranteve, bareve, hoteleve, udhëtimeve dhe pushimeve brenda vendit, palestra, shërbime për mirëmbajtje trupi), shpenzime të mundshme mjekësore/dentare, etj., – sigurisht që do të arrinin në një shumëfish të shumës simbolike prej 3 eurosh në ditë për shpenzimet jetike për një anëtar të çdo familjeje të shtresës së mesme, kudo që ajo të ketë banuar dhe, natyrisht, akoma më tepër për shtresën e lartë.

Për sa i përket mosdeklarimit të të ardhurave të bashkëshortes për vitin 2006, ashtu si edhe për mospërputhjen e shifrave të pasqyruara ndër vite si fitime të realizuara nga aktiviteti i znj. E. A.,

¹⁰ Si për shembull: u përllogarit periudha e fitimeve në periudhën 1992 - 2003, sipas dokumentacionit/analizës të përcjellë nga subjekti; u zbritën kostot e udhëtimeve zyrtare për të cilat u provua që pagesat ishin kryer nga institucionet, si dhe u mor në konsideratë gjendja në llogarinë bankare në “Raiffaisen Bank” në vitin 2003, që nuk ishte e deklaruar saktë nga banka.

ato vlerësohen dhe konsiderohen si deklarime të paplota, të pamjaftueshme dhe të pasakta, sipas rastit, në përputhje me dispozitat ligjore.

Në sajë të rezultateve financiare të shpjeguara më lart, konstatohet një mungesë burimesh financiare të ligjshme, në periudhën 1992 – 2003, si dhe në vitet 2004, 2005, 2008 dhe 2009, që të mund të mjaftonin për të përballuar të gjitha shpenzimet e kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit në periudhat respektive, si dhe për të realizuar kursimet e deklaruara. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se, në prezencën e provave të deklarimeve të pamjaftueshme dhe të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera, duhet aplikuar neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

5- Mbi kontrollin e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve të tij dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e kontakteve të mundshme të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. (***)prot., datë 02.11.2017, në lidhje me subjektin e rivlerësimit dhe në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Sipas këtij raporti, rezulton se:

- 1- *Subjekti i rivlerësimit, z. Admir S. Thanza, ka plotësuar saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, të firmosur më datë 25.01.2016.*
- 2- *Subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato që janë deklaruar në deklaratën e sipërpërmendur.*
- 3- *Subjekti nuk ka deklaruar me vërtetësi, pasi nuk ka deklaruar procedimin penal në ngarkim të tij, për veprën penale të parashikuar nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal. Kjo çështje rezulton të jetë pushuar më datë 29 korrik 2016.*
- 4- *Ekzistojnë të dhëna se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme.*
- 5- *Ka, gjithashtu, pasaktësi në plotësimin e Deklaratës për Kontrollin e Figurës, pasi subjekti nuk ka deklaruar kontaktet e papërshtatshme që ka pasur me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Ky mosdeklarim e ngarkon subjektin me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti dhe të plotësimit të pasaktë dhe jo të vërtetë të Deklaratës për Kontrollin e Figurës.*

Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë e z. Admir Thanza për vazhdimin e detyrës.

Gjithashtu, DSIK-ja, bashkëngjitur me raportin e sipërcituar, ka përcjellë edhe vendimin e datës 29.07.2016, nëpërmjet të cilit rezulton se Prokuroria e Përgjithshme ka pushuar hetimin e kryer

ndaj subjektit të rivlerësimit dhe shtetases L. H. për veprën penale të parashikuar nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal.

5.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me kontrollin e figurës

Subjekti i rivlerësimit ka pranuar faktin se nuk e ka pasqyruar në deklaratën e figurës, – të plotësuar dhe nënshkruar prej tij në datën 25.01.2017, – ekzistencën ndaj tij të çështjes penale nr. 3, për veprën penale të parashikuar nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal, të pushuar më datë 29 korrik 2016. Por, ai e shpjegoi këtë mosdeklarim me arsyetimin se, nga momenti që kjo çështje është pushuar, – pasi faktet e provuara nga hetimi nuk përmbushin elementet e veprës penale për të cilën ishte hetuar, – ajo nuk duhej të ishte deklaruar. Sipas tij, në këtë konkluzion arrihej duke iu referuar pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 i cili, veç të tjerash, në përkufizimin e “personit të përfshirë në krimin e organizuar” parashikon përjashtimin e rastit kur ai është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Në sajë të një vlerësimi të bërë nga subjekti i rivlerësimit, sipas të cilit vendimi i pushimit të një hetimi duhet të konsiderohet i barasvlershëm me një vendim gjyqësor pafajësie të formës së prerë, (citon V. nr. 126/2016 të Gj.L.) dhe për rrjedhojë nga ana e tij nuk duhej të deklarohet procedimi penal nr. 3/2016, pasi hynte te rastet e përjashtuara, – si më lart, – nga neni 3 i ligjit nr. 84/2016.

Ndërsa, në lidhje me pikën 2/c, të raportit të DSIK-së, që referon informacione mbi të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e vetë subjektit apo për kontakte të papërshtatshme të tij me persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe në lidhje me pikën 3 të raportit të DSIK-së që, – duke marrë shkas nga vendimi i pushimit nr. 3/2016, e vlerëson subjektin si një person me tendencë për përfshirje në veprimtari kriminale; vihet re implikimi i tij në veprimtari korruptive dhe e konsideron atë si një individ që mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale, – subjekti i rivlerësimit i kundërshton këto konkluzione sepse, sipas tij, ka qenë pikërisht Prokuroria e Përgjithshme që ka vendosur pushimin e çështjes për korruption aktiv dhe/ose pasiv, pasi nuk ka pasur fakte të provuara që të çonin në një përfshirje të tij apo të shtetases L.H. në një sjellje me implikim korruptiv. Subjekti vlerëson se konkludimet e DSIK-së janë të gabuara pasi ato prezumojnë fajësinë dhe bien ndesh pikërisht me parimin e prezumimit të pafajësisë, deri në arritjen e provës së kundërt.

5.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me raportin e DSIK-së dhe me kontrollin e figurës

Në lidhje me interpretimin e pikës 15, neni 3, i ligjit nr. 84/2016, të bërë nga subjekti i rivlerësimit, sipas të cilit përjashtimi nga konsiderimi i një personi si i përfshirë në krimin e organizuar mund të kryhet edhe në rastin e dhënies së një vendimi pushimi nga ana e një prokurori dhe mund të konsiderohet i barabartë me një vendim gjyqësor pafajësie të formës së prerë, trupi gjykues vlerëson se:

- a- praktika gjyqësore e cituar nga subjekti i rivlerësimit, – V.Gj.L. nr. 126/2016, – nuk është e unifikuar dhe nuk rezulton të jetë e konsoliduar, përtej rrethanave specifike në të cilat është përdorur/vendosur në atë rast;

- b- vendimi gjyqësor i formës së prerë është fryt i konkludimit të një procesi të mirëfilltë gjyqësor – që përshkon të gjithë hapat proceduralë, me garancitë e palëve dhe me një vlerësim provash nga një trup gjykues, në respekt të parimit të kontradiktoritetit, me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara që mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, dhe pikërisht për këtë ai përbën në vetvete një “*gjë të gjykuar*”. Ndërsa një vendim pushimi nuk prodhon të njëjtin efekt, pasi hetimi i pushuar mund të riçelet në çdo moment, kjo pasi parimi *ne bis in idem* vlen vetëm për gjykimet, pra për vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe jo për hetimet;
- c- ligjvënësi, në mënyrë të qartë, përkrah kushteve për vlerësimin e një personi si të përfshirë në krimin e organizuar, në ligjin e posaçëm nr. 10192/2009, ka parashikuar shprehimisht si përjashtim vetëm rastin “*kur është deklaruar pafajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë*”, – rrethanë kjo e referuar edhe nga një tjetër ligj i posaçëm, ai nr. 84/2016, në pikën 15 të nenit 3, dhe nuk ka parashikuar raste të tjera ekuivalente. Kjo do të thotë që ligji i posaçëm nuk i ka lejuar organit kompetent ligjzbatues (DSIK-së) një hapësirë interpretimi apo diskrecion vlerësimi, por i ka diktuar atij në mënyrë taksative rastin e vetëm kur mund të bëjë një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm për të konsideruar një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- d- Veç të tjerash, ligji i posaçëm (si më lart) parashikon edhe raste në të cilat, pavarësisht vendimit të pafajësisë të dhënë ndaj një personi që nuk mund të akuzohet apo dënohet, ky i fundit konsiderohet gjithsesi i përfshirë në krimin e organizuar, – kjo do të thotë që standardi i vlerësimit të pastërtisë së figurës shkon përtej ndëshkueshmërisë së parashikuar për kryerjen e veprave penale.

Për sa i përket justifikimit të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me mosdeklarimin e procedimit penal nr. 3/2016 se, nuk ka pasur pasaktësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, pasi çështja ishte pushuar, trupi gjykues e konsideron atë të pabazuar. Kjo për faktin që, sipas pikës 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për të deklaruar kontaktin e papërshtatshëm, në pikën “ç”, te pjesa e pestë e formularit, me titull “Të dhëna mbi sigurinë”. Deklarimi duhej të ishte kryer sipas përkufizimit të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pra subjekti duhej të kishte deklaruar çështjen penale nr. 3, dhe nëse ishte rasti, ai njëkohësisht mund të specifikonte ekzistencën e mundshme të rrethanave lehtësuese. Kështu që, rrjedhimisht, mosdeklarimi i faktit të sipërcituar përbën një deklaram të pasaktë në kuptimin e nenit DH të Kushtetutës, si dhe të pikës 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu, trupi gjykues i konsideron të mirëqena konstatimet e Grupit të Punës mbi subjektin e rivlerësimit, të kryera sipas nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, pikat “b” dhe “c”, sipas të cilit: “... subjekti ka tendencë në përfshirjen në veprimtari kriminale dhe është një individ që mund të vihet lehtësisht në presion nga strukturat kriminale ...”, si dhe në bazë të pikës 4 të nenit 38 të po atij ligji, “...subjekti ka kontakte të papërshtatshme...”, duke konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës. Vlerësimi dhe përdorimi i këtyre konkluzioneve të DSIK-së duhet të bëhet me sy kritik dhe analizë logjike, por edhe me respekt ndërinstitucional, pasi ato janë

fryt i punës së një strukture përgjegjëse, të posaçme, të specializuar dhe të ngarkuar me detyrën e verifikimit, lëvrimit dhe vlerësimit të kombinuar të të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38, të ligjit nr. 84/2016, mbi figurën e subjektit të rivlerësimit, ku ata kanë akses të plotë.

Ky vlerësim dhe qëndrim vlen për aq kohë sa Komisioni, gjatë zhvillimit të hetimeve të tij dhe nëpërmjet dokumentacionit të administruar, nuk ka konstatuar fakte ndryshe, si dhe përderisa subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën.

Kështu që, në mënyrë të përmbledhur, në lidhje me kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit konstatohet deklarim i pasaktë dhe i pavërtetë, si dhe ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme dhe, për rrjedhojë, në bazë të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet si i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

5.3 Konkluzione mbi kontrollin e figurës

Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, i) deklaratën për kontrollin e figurës; ii) raportin e DSIK-së, si dhe iii) zhvilloi një hetim të thelluar kryesisht, bazuar në parimin e transparencës, procesit të rregullt ligjor, eficiencës, barazisë së palëve në procesin gjyqësor, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të figurës, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo me vërtetësi. Nga analiza e të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38, i ligjit nr. 84/2016, dhe kryesisht bazuar në raportin e DSIK-së, rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe mund të vihet nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë konkludohet se ai është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe duhet aplikuar neni DH i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 2 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

6- Mbi vlerësimin e aftësive profesionale

Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka përcjellë në Komision një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. (***)prot., më datë 17.11.2017.

Raporti i përpiluar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si më sipër, mbi “Aftësitë profesionale”, në paragrafin e raportit të dedikuar “**Aftësive organizative**”, shprehet që: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Admir Thanza, **ka pasur mangësi në aftësinë për të administruar dosjet, pasi ka pasur mungesë të relacionit të relatorit, relacionet e këshilltarëve janë gjetur pa datë dhe pa firmë, dosjet kanë qenë pa listën e shpalljes së seancave dhe nuk ka pasur akt delegimi me detyrat e ngarkuara për**

këshilltarët. Në 3 prej 5 dosjeve mungonte procesverbali për seancën në dhomë këshillimi, në mosrespektim të nenit 118 të K. P. Civile (dosjet nr.: 3-4-5)”.

Pra, rezultoi se Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë kishte konstatuar mangësi në aftësinë e administrimit të dosjeve, por, gjithsesi, duke qenë pozitive të gjitha vlerësimet e tjera profesionale të kryera prej tij, ai ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit është i aftë për vazhdimin e detyrës së tij.

Subjekti i rivlerësimit i kundërshtoi konkluzionet e Inspektoratit të KLD-së në lidhje me mangësitë e konstatuara sepse, sipas tij, të gjitha veprimtaritë procedurale ku mund të ketë pasur mangësi kanë qenë detyrë dhe kompetencë e ndihmësve ligjorë dhe, për rrjedhojë, ai nuk mund të kishte asnjë përgjegjësi mbi këto fakte, të cilat nuk lidhen me aftësitë organizative të një gjyqtari të Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Admir Thanza, u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe ankesat e shtetasve, si më poshtë:

- 1. Denoncimi i shtetases F.D. Ankesa drejtohej ndaj 5 gjyqtarëve.*
- 2. Denoncimi i shtetasit K.D. Ankesa drejtohej ndaj 3 gjyqtarëve.*
- 3. Denoncimi i shtetasit A.B. Ankesa drejtohet ndaj 17 gjyqtarëve.*
- 4. Denoncimi i shtetasit V.Q. Ankesa drejtohej vetëm ndaj subjektit të rivlerësimit.*
- 5. Denoncimi i shtetases V. C. Edhe në këtë rast ankesa drejtohej vetëm ndaj subjektit të rivlerësimit.*
- 6. Denoncimi i shtetasit V.P. Ankesa drejtohej ndaj 3 gjyqtarëve.*
- 7. Denoncimi i shtetasit A.G. Edhe kjo ankesë drejtohej ndaj 3 gjyqtarëve.*
- 8. Denoncimi i shtetases M.H. Ankesa drejtohej vetëm ndaj subjektit të rivlerësimit.*
- 9. Denoncimi i shtetasit A. Rr. Ankesa drejtohet ndaj 19 gjyqtarëve.*
- 10. Si në pikën 8. Denoncim i përsëritur me dokumentacion të bashkëngjitur.*
- 11. Denoncimi i shtetasit T.Nd. Ankesa drejtohet ndaj 7 gjyqtarëve.*
- 12. Denoncimi i shtetasit G.T. Ankesa drejtohet ndaj 50 gjyqtarëve.*
- 13. Denoncimi i shtetasit R.M. Ankesa drejtohet ndaj 6 gjyqtarëve.*
- 14-20 Gjithashtu, pranë Komisionit janë paraqitur edhe 7 denoncime të tjera, të cilat nuk janë shqyrtuar pasi ato kanë mbërritur pas mbylljes së hetimit administrativ. Për këtë arsye, ato janë administruar dhe gjithsesi janë bërë pjesë e dosjes.*

6.1 Përmbledhje e objektit të denoncimeve të administruara

Ankesa nr. 1.

Në denoncimin e saj shprehet se një proces në Gjykatën e Lartë, ku ajo ishte palë, është zhvilluar në shkelje të ligjit pasi ajo nuk ishte njoftuar për zhvillimin e tij. Rezultoi se njoftimi ishte publikuar në mënyrat e parashikuara. Kështu që pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur, nuk rezultuan të provuara pretendimet e ngritura.

Ankesa nr. 2.

Në denoncimin e tij, shtetasi K. D. pretendon se në Gjykatën e Lartë është dhënë një vendim i padrejtë, duke e shoqëruar me dokumentacion përkatës. Ky vlerësim (në themel) nuk hyn në kompetencën e Komisionit.

Ankesa nr. 3.

Në denoncimin e tij, pretendon se subjekti i rivlerësimit, së bashku me kolegët e tij, ka marrë një shumë prej 50.000 eurosh nga shtetasi A. H. për të dhënë një vendim të padrejtë, në sajë të drejtësisë së korruptuar dhe në favor të palës tjetër ndërgjyqëse. Por, përtej indiceve, nuk rezultoi prezenca e elementeve të nevojshme për të provuar pretendimet e ngritura.

Ankesa nr. 4.

Në denoncimin e tij, shtetasi V. Q. pretendon se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim të padrejtë dhe të njëanshëm, pasi ai ka qenë "i blerë", duke aluduar për rrethana korruptive, por duke mos u evidentuar ndonjë shkelje ligjore konkrete e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Po ashtu, nuk u konstatuan elemente provuese të pretendimeve dhe aludimeve korruptive.

Ankesa nr. 5.

Në denoncimin e tij, V. C. pretendon se në një gjyq në Gjykatën e Lartë nuk është thirrur fare, pasi subjekti i rivlerësimit e ka kaluar çështjen në dhomë këshillimi. Ai pohon që nuk e njeh z. Admir Thanza, por pretendon se ky i fundit ka marrë një vendim të padrejtë dhe të njëanshëm ndaj tij dhe aludon për rrethana korruptive. Vlerësimi mbi vendimmarrjen nuk është në kompetencat e Komisionit. Nuk u konstatuan elemente provues të pretendimeve dhe aludimeve korruptive.

Ankesa nr. 6.

Në denoncimin e tij, shtetasi V. P. pretendon se subjekti i rivlerësimit ka shpërdoruar detyrën dhe ka qenë i përfshirë në korrupsion pasiv, pasi në Gjykatën e Lartë ka marrë vendim (nr. 418, datë 07.10.2015) të padrejtë dhe të njëanshëm, duke u bazuar në dokumentacion të falsifikuar për qëllime përfitimi dhe në këtë mënyrë ka favorizuar palën paditëse. Por, duke mos u evidentuar ndonjë shkelje ligjore konkrete e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Po ashtu, nuk u konstatuan elemente provuese të pretendimeve dhe aludimeve korruptive.

Ankesa nr. 7.

Në denoncimin e tij, shtetasi A. G. pretendon se subjekti i rivlerësimit bashkë me dy kolegët e tij ka qenë i përfshirë në korrupsion pasiv, pasi në Gjykatën e Lartë ka marrë vendim (nr. 317, datë 29.05.2015) pezullimi për ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, vetëm me qëllimin për të favorizuar palën tjetër. Por, nuk janë përcjellë elemente konkrete dhe as nuk u konstatuan fakte provuese të pretendimeve dhe aludimeve korruptive.

Ankesa nr. 8.

Në denoncimin e saj, shtetasja M. H. shprehet se një proces në Gjykatën e Lartë, ku ajo ishte palë, është zhvilluar në shkelje të ligjit, pasi ajo nuk ishte njoftuar për zhvillimin e tij. Rezultoi se njoftimi ishte publikuar në mënyrat e parashikuara. Kështu që, pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur, nuk rezultuan të provuara pretendimet e ngritura.

Ankesa nr. 9.

Në denoncimin e tij, shtetasi A. Rr. pretendon se ndaj tij janë dhënë vendime të padrejta, për mungesë të aftësive profesionale të 19 gjykatësve, të përfshirë në korrupsion. Këto pretendime nuk rezultojnë të jenë shoqëruar me dokumentacion përkatës, për të evidentuar anomalitë e aluduara, të cilat mbeten në nivel indice.

Ankesa nr. 10.

Si në ankesën nr. 8 – e bërë nga i njëjti person (M. H.), e përsëritur dhe me dokumentacion të bashkëngjitur. Vlerësimi edhe i kësaj ankese të çon në të njëjtin konkludim.

Ankesa nr. 11.

Në denoncimin e tij, shtetasi T. N. pretendon se ndaj tij janë kryer hetime dhe janë dhënë vendime të padrejta, për shkak të përfshirjes në korrupsion. Për sa i përket subjektit të rivlerësimit, ai përmendet në këtë denoncim vetëm sepse kur ka qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit nuk ka shqyrtuar/pranuar një ankim të paraqitur nga denoncuesi.

Ankesa nr. 12.

Në denoncimin e tij, shtetasi G. T. shprehet se të gjitha subjektet e denoncuara kanë zhvilluar procedura në shkelje të ligjit, pasi kanë qenë të korrumpuar. Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur, nuk rezultuan prova mbi pretendimet e ngritura, që të përfshinin subjektin Admir Thanza.

Ankesa nr. 13.

Në denoncimin e tij, shtetasi R. M. pretendon se Gjykata e Lartë ka dhënë vendim të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin, pasi ajo nuk ka marrë në shqyrtim dosjet e dy shkallëve të tjera, si dhe ai nuk është thirrur fare në seancë. Vlerësimi mbi vendimmarrjen nuk është në kompetencat e Komisionit. Njoftimi është bërë nëpërmjet publikimit të datave të seancave, sipas procedurave të parashikuara.

7- Mbi etikën dhe integritetin

Gjatë fazës së hetimit dhe konkretisht nëpërmjet analizimit të përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në vijim të pyetjeve të bëra nga Komisioni, u konstatua se:

- a- Në përgjigjen nr. 2, të pyetësorit të parë, të dhënë më datë 20.12.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “As unë dhe as familjarët e mi nuk kemi marrë ndonjë dhuratë, me vlerë mbi 500 euro në periudhën 2011 - 2017”.
- b- Në përgjigje të pikës së dytë, të pyetjes së dytë, të pyetësorit të nisur në datën 10.03.2018, subjekti ka pohuar se: “Nuk ka ndonjë rast që të më kenë bërë dhurata ose favore të tjera, apo të më jenë premtuar dhurata ose favore nga persona ndaj të cilëve kam marrë vendime apo kam kontribuar në vendimmarrje, apo që mund të kenë qenë të interesuar mbi çështjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ...”.
- c- Nga kontrata e datës 22.04.2017, nr. (***)rep., rezulton se: “Shoqëria “(***)” sh.p.k., me NIPT (***), u ka dhuruar zotërinjve: S. Th.; F. Th.; Admir Thanza; E. A. një garazh me sipërfaqe 18 m² të ndodhur në Shkodër, Rr. “(***)”, me nr. pasurie (***)- N(***), vol

(**), faqe (**), – secilit pranues të dhuratës i përket ¼ e garazhit, si pjesë takuese e pandarë”.

- d- Gjithashtu, nëpërmjet shkresës së Gjykatës së Lartë, nr. (**) prot., datë 06.04.2018, rezultoi se dhuruesi, shoqëria “(” sh.p.k. ishte palë, veç të tjerash, në një çështje të regjistruar në vitin 2015, me nr. (**) /2015 akti, dhe në një tjetër të regjistruar në vitin 2016, me nr. (**) /2016 akti. Të dyja këto çështje ndodhen në fazë studimi. Po ashtu, shoqëria “(” sh.p.k rezultoi të ketë qenë palë edhe në një tjetër çështje të regjistruar në Gjykatën e Lartë në vitin 2017, me nr. regjistri themeltar: (**) -2017 dhe me nr. (**) /2018 akti, ku z. Admir Thanza ishte relator. Kjo çështje rezultoi të përfunduar/vendosur më datë 06.03.2018, me vendimin nr. (**).

Nga sa më lart, rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Admir Thanza, kishte mohuar faktin e marrjes së një sendi si dhuratë nga një shoqëri që kishte pasur çështje në Gjykatën e Lartë, ku vetë subjekti kishte qenë relator dhe nuk kishte kërkuar dorëheqjen për konflikt interesi. Po ashtu ai mohoi, – në pyetësorin e datës 10.03.2018, – se pikërisht katër ditë më parë (më datë 06.03.2018) ai kishte dhënë një vendim ku palë ishte një person (apo subjekt juridik) që i kishte bërë një dhuratë me vlerë mbi 500 euro.

7.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me etikën

Në lidhje me sa më lart, subjekti i pranoi faktet e konstatuara nga Komisioni, por sqaroi se, sipas tij, nuk bëhej fjalë për një dhurim të garazhit, pasi akti i dhurimit ishte bërë fiktiv, vetëm me qëllim që të formalizohej pronësia e tij, që edhe pse ishte blerë së bashku me një apartament në vitin 2000, çuditërisht ishte regjistruar në emër të kompanisë ndërtuese dhe jo të blerësve. Gjithashtu, subjekti paraqiti një deklaratë pranë noterit A. K., i cili pohon t’u ketë sugjeruar palëve të firmosnin një kontratë dhurimi fiktive, pasi kontrata e shitblerjes mund të bëhej vetëm nëpërmjet kryerjes së pagesës së çmimit, gjë që palët nuk ishin dakord ta bënin sepse, sipas tyre, likuidimi i vlerës së garazhit ishte kryer në vitin 2000.

7.2 Mbi integritetin dhe precedentët penalë të subjektit të rivlerësimit

- a- Komisioni, gjatë hetimit administrativ, më datë 10 mars 2018 i ka komunikuar subjektit të rivlerësimit pyetësorin nr. 2, në pyetjen nr. 8. Atij i kërkohej nëse kishte qenë ndonjëherë i hetuar, i ndaluar, i shoqëruar nga organet ligjzbatuese, i arrestuar, i dënues me vendim gjyqësor në Shqipëri apo në ndonjë tjetër shtet të huaj.
- b- Subjekti, në përgjigje të pyetjes së mësipërme, citonte një hetim të kryer ndaj tij në Shqipëri për korrupsion dhe të pushuar në vitin 2016, por mohonte ekzistencën e ndonjë ndalimi, hetimi, procedimi apo dënimi ndaj tij.
- c- Subjekti, po ashtu, në plotësimin e Formularit të Vetëdeklarimit, të kryer në zbatim të ligjit nr. 138/2015, të firmosur në datën 25 prill 2016, në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të tij, nuk përmend asnjë rast që të ketë qenë i ndaluar, i arrestuar, i hetuar, i gjykuar, apo i dënues me vendim

gjyqësor jopërfundimtar ose të formës së prerë, nga organet ligjzbatuese ose nga një autoritet gjyqësor, shqiptar ose i huaj;

- d- Përgjatë hetimit të kryer, Komisioni administroi dokumente në lidhje me një gjetje të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të bashkëngjitura me një shkresë përcjellëse të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, me nr(***)prot., datë 20.04.2018, nga ku rezultonte se: *“Z. Admir S. Thanza, i datëlindjes 18.09.1969, lindur në Shkodër, ka qenë i dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, në Pisa të Italisë, në datën 21.06.1999, me 40 ditë burg dhe 100.000 lireta gjobë, për vjedhje në bashkëpunim me persona të tjerë. Gjykata e sipërpërmendur ka caktuar pezullim me kusht të ekzekutimit të vendimit në fjalë. Ky vendim ka marrë formë të prerë”*.

7.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me precedentin penal në Itali

Z. Admir Thanza e pranoi faktin që vendimi i formës së prerë ishte dhënë ndaj tij në Itali, por ai mohoi që të kishte kryer veprën penale për të cilën ishte dënuar. Ai sqaroi se kishte bërë një zgjedhje të gabuar, kur kishte marrë përsipër, përpara efektivëve të Policisë italiane, një përgjegjësi të tjerëve, i detyruar nga rrethanat familjare, si dhe i shtyrë nga ndjenja humanitare.

Për sa i përket mosdeklarimit të këtij precedenti penal, subjekti shpjegoi se ditën që ishte dhënë vendimi – ku ai ishte prezent – e kishte kuptuar që avokati i tij kishte rënë dakord me prokurorin që çështja mund të mbyllej vetëm me një gjobë. Gjithashtu, atij i ishte vënë në dispozicion një dëshmi penaliteti në të cilën nuk rezultonte asnjë shënim mbi dënimin në fjalë dhe, për rrjedhojë, ai mendonte se çdo gjë, në lidhje me atë fakt të largët, ishte mbyllur.

Së fundmi, z. Admir Thanza ka arsyetuar që ai u është përgjigjur “jo” pikave 2, 3 dhe 4 të Formularit të Vetëdeklarimit, jo për të fshehur dënimin e tij, por sepse ai e konsideronte detyrimin e deklarimit vetëm për dënimet e dhëna për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga ligji nr. 138/2015, si një shkak ndalimi/pengues për të qenë kandidat, i zgjedhur, i emëruar ose për të vijuar detyrën në një funksion të lartë publik dhe vepra penale e klasifikuar nga gjykata italiane nuk përfshihet ndër ato të parashikuara nga neni 2 i ligjit të sipërpërmendur.

7.4 Arsyetimi ligjor në lidhje me etikën dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit

- a- **Etika:** Për sa u përket shpjegimeve mbi faktin e pranimit të një dhurimi (garazhi) nga z. Admir Thanza së bashku me familjarët e tij, Komisioni vëren se ato nuk janë bindëse. Jemi përballë një kontrate të mirëfilltë dhurimi, që përmbush të gjitha elementet formale dhe nuk mund të pretendohet që ajo të mos prodhojë efektet e veta juridike, – përfshirë këtu edhe pasojat apo kufizimet e etikës profesionale të njërit nga pranuesit e dhurimit, – vetëm sepse, pas konstatimit të saj nga Komisioni, pohohet verbalisht se ajo ishte fiktive. Një gjyqtar i Gjykatës së Lartë nuk mund të nënshkruajë kontrata vetëm për faktin sepse ato sugjerohen nga ana e një noteri, pa vlerësuar pasojat dhe pa marrë vetë përgjegjësitë e një veprimi juridik të kryer me vullnet të lirë dhe në posedim të plotë të aftësive intelektuale. Gjithashtu, kur nënshkruhet një kontratë fiktive, ajo duhet të shoqërohet me

një tjetër akt ku specifikohet fakti që efektet e kontratës në dukje nuk ishin objektivi/vullneti i vërtetë i palëve, duke u qartësuar dhe specifikuar vullneti real i fshehur. Në këtë rast, nuk ka ndodhur asgjë e tillë.

Gjithsesi, edhe nëse do ta konsideronim si të mirëqenë versionin e subjektit të rivlerësimit mbi fiktivitetin e kontratës, dhe përtej pasojave së kontratës fiktive, mbetet i pashmangshëm fakti i mohimit të shumëfishët nga ana e z. Admir Thanza të ekzistencës (qoftë edhe vetëm formalisht) të një kontrate dhurimi me “C” sh.p.k., si dhe të faktit që ai kishte dhënë një vendim, –në një çështje ku dhuruesi “C” sh.p.k. ishte palë, – vetëm pak ditë përpara sesa të formulonte përgjigjet mohuese në pyetësorin e Komisionit. Subjekti mund të kishte qenë më bindës nëse do të kishte pohuar ekzistencën e kontratës së dhurimit në fjalë, si dhe vendimmarrjen e tij të datës 6 mars 2018, duke shpjeguar rrethanat dhe arsyet që, sipas tij, nuk kishte qenë një dhurim dhe që nuk kishte pasur konflikt interesi për të paraqitur dorëheqjen nga gjykimi i asaj dosjeje. Duke munguar në këtë prizëm, subjekti i shton dyshimet e arsyeshme mbi tentativën e fshehjes të së vërtetës ndaj Komisionit.

Gjithashtu, kujtojmë që KLD-ja, edhe pse me një vendimin të hershëm, – datë 15.01.2000, nr. 67, pika 6, – ka dhënë një masë disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim*”, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, z. Admir Thanza, “*Për kryerjen e veprimeve që sipas ligjit janë të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit*”. Në atë periudhë, subjekti ishte me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në vijim të analizës së fakteve dhe rrethanave të mësipërme, vlerësohet se këto të fundit nuk janë në përputhje të plotë me parimet e paanshmërisë dhe të integritetit, sipas të cilave:

- *Gjyqtarët nuk duhet që të pranojnë asnjë dhuratë, favor apo avantazh që mund të cenojë pavarësinë apo paanshmërinë e tyre gjatë një procesi gjyqësor;*
- *Gjyqtarët duhet që të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme duke e garantuar dhe evidentuar paanshmërinë. Ata duhet që të kujdesen që të shmangin në çdo rast konfliktin e interesit, por edhe përzierjen në të gjitha ato situata të cilat perceptohet se e përfshijnë apo krijojnë për gjyqtarët konflikt të interesave apo dyshime të arsyeshme mbi integritetin;*
- *Drejtimi i gjykimi duhet të jetë në përputhje me një moral të lartë, që është edhe një kriter për zyrat gjyqësore. Ata duhet që të jenë në çdo rast të kthjellët dhe të qartë për të përmbushur detyrën e tyre në respekt edhe të reputacionit të Gjykatës.*

- b- **Lidhur me integritetin** dhe me mosdeklarimin e dënimit me 40 ditë burg dhe 100.000 lireta gjobë, të dhënë nga gjykata italiane, në plotësimin e pikave 1, 2, 3, 4 dhe 5 të Formularit të Vetëdeklarimit, të kryer në zbatim të ligjit nr. 138/2015, të firmosur në datën 25 prill 2016, – ku subjekti mohon që të ketë qenë i ndaluar, i arrestuar, i hetuar, i gjykuar, apo i dënuar me vendim gjyqësor jo përfundimtar ose të formës së prerë, nga organet ligjzbatuese ose nga një autoritet gjyqësor, shqiptar ose i huaj, trupi gjykues vlerëson se justifikimet e shprehura nuk qëndrojnë, sepse:

- 1- Së pari, nuk konsiderohet bindës pohimi që subjekti nuk njihte përmbajtjen e vërtetë të dënimit të dhënë ndaj tij, për më tepër që ai ka qenë prezent në sallën e gjyqit, ku ka qenë i asistuar nga një përkthyes dhe i mbrojtur nga një avokat. Nuk kuptohet cila mund të ketë qenë arsyeja që këta t'i referonin subjektit një informacion të pavërtetë, pikërisht mbi një fakt kaq të rëndësishëm, si një vendim dënimi. Në çdo rast edhe më pas subjektit nuk i kanë munguar mundësitë për të verifikuar dhe për të mësuar saktësisht llojin dhe sasinë e dënimit të dhënë ndaj tij.
- 2- Së dyti, Komisioni vëren se në kuadër të rivlerësimit të subjektit, nuk ka shumë rëndësi qartësimi nëse ai e ka kryer dhe në çfarë rrethanash e ka kryer veprën penale për të cilën është dënuar. Por, duke u ndodhur përballë një vendimi të formës së prerë, analiza bëhet mbi mosdeklarimin e tij dhe mbi pasojat e mosdeklarimit.
- 3- Së treti, Komisioni konstaton që Formulari i Vetëdeklarimit është më se i qartë në formulimin e pyetjeve të hapura dhe gjithëpërfshirëse në pikat “1”, “5” (“... a jeni ... ndaluar, hetuar, gjykuar, dënuar ndonjëherë ... në Shqipëri apo në ndonjë shtet të huaj...”), pa pasur asnjë specifikim mbi tipologjinë dhe peshën e veprës penale, që duhej të deklarohesh gjithçka dhe në çdo kohë që kishte ndodhur, pavarësisht efekteve apo pasojave që ajo mund të prodhonte apo jo në bazë të ligjit nr. 138/2015. Në mbështetje të sa më lart, specifikohet fakti që dikush mund të ketë qenë i ndaluar pa iu formuluar asnjë akuzë formale. Por, kjo nuk do të thotë se në këtë rast nuk duhej të deklarohesh masa provizore e ndalimit.
- 4- Së katërti, trupi gjykues vlerëson se etika dhe integriteti i subjektit të rivlerësimit rezultojnë të cingëruara edhe për faktin se, përveçse në formularët si më lart, edhe në pyetësorët e Komisionit, në disa raste të përsëritura, z. Admir Thanza ka mohuar të vërtetën edhe përpara Komisionit: mbi marrjen e dhuratave mbi 500 euro, mbi dhënien e vendimeve në çështje me palë “C” sh.p.k. -“dhurues”, mbi ekzistencën e ndalimit, hetimit, gjykimit, dënimit në Itali – edhe pse në pyetësorët në fjalë nuk kishte dhe nuk mund të mendohej që të kishte ndonjë kufizim ose ndonjë dallim/përjashtim në lidhje me llojin dhe rëndësinë e veprës penale. Në fakt, ai, me pyetësorin nr. 2, të datës 10 mars 2018, në pyetjen nr. 8, thjesht ishte pyetur nëse: “*Kishte qenë ndonjëherë i hetuar, i ndaluar, i shoqëruar nga organet ligjzbatuese, i arrestuar, i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në Shqipëri apo në ndonjë tjetër shtet të huaj*”. Dhe përgjigjet e dhëna nga subjekti ishin vetëm: “*Jo*”;
- 5- Së fundmi, në bazë të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, nën një këndvështrim dhe vlerësim tërësor, të veprimeve apo mosveprimeve të analizuara më lart, mosdeklarimi në vetëdeklarim dhe mohimi në pyetësorët e Komisionit: i procedimit, masës dhe dënimit të marrë në Itali; mosdeklarimi i procedimit hetimor të vitit 2016 në deklarimin e kontrollit të figurës; mosdeklarimi në pyetësorët e Komisionit i dhënies së një vendimi ndaj një dhuruesi (të paktën formalisht), dhe mohimi i kontratës së dhurimit të bërë në favor të tij; problemet me etikën dhe mosdorëheqja e tij nga gjykimi i çështjes, ku njëra nga palët ishte formalisht dhuruesja e një garazhi për subjektin dhe familjarët

e tij; konstatimi i papërshtatshmërisë së tij me detyrën e gjyqtarit; mangësitë e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe pasurinë; kryerja e deklarimeve të pamjaftueshme apo fiktive (edhe përpara një noteri), – Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Admir Thanza, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, sistem në të cilin ai ka qenë në nivele të larta, për shumë vite. Për rrjedhojë, duhet aplikuar pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Si konkluzion, trupi gjykues, pasi konstatoi se:

a- në lidhje me rivlerësimin e pasurisë:

- i) *Nuk është deklaruar çmimi i pasqyruar në kontratën e shitblerjes për apartamentin në Rr. “(***)”, Shkodër, prej 1.200.000 lekësh, por ai është deklaruar nga subjekti në vlerën prej 3.000.000 lekësh.*
- ii) *Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, e dorëzuar më datë 17.03.2004, mungon deklarimi i garazhit të blerë në Rr. “(***)”, Shkodër.*
- iii) *Çmimi i pasqyruar në kontratë (prej 1.200.000 lekësh), për apartamentin në Rr. “(***)”, Shkodër, rezulton të jetë shumë më i vogël, në krahasim me çmimin mesatar të tregut.*
- iv) *Modifikimi i bërë në njërin nga formularët “A1”, në faqen nr. 4, – tek ai që mban dy data– është bërë jo në përputhje me procedurat dhe udhëzimet e institucionit përkatës, pasi mungon një procesverbal që të pasqyrojë këtë veprim ndërhyrjeje në një dosje të administruar.*
- v) *Shuma e cituar për rregullimet/punimet e pretenduara nuk rezulton të jetë e provuar me dokumentacion relativ.*
- vi) *Të ardhurat nga shitja e kryer më datë 16.11.2000, – të deklaruara nga subjekti si burim financiar për blerjen e apartamentit në Rr. “(***)”, Shkodër, – nuk mund të përdorshin për pagesën e blerjes së tij, të realizuar më datë 06.04.2000, pasi shitja është kryer në nëntor të vitit 2000.*
- vii) *Çmimi i apartamentit në Rr. “(***)”, prej 113 m², i deklaruar në vlerën prej 4.000.000 lekësh, në deklaratën e vitit 2003, nuk përputhet me atë të pasqyruar në kontratën e shitblerjes, që ka rezultuar se ishte 1.950.000 lekë.*
- viii) *Garazhi në Rr. “(***)” nuk ka qenë i deklaruar as kur ai është blerë, në deklaratën e vitit 2007, dhe as në deklaratat e viteve të mëpasshme, 2008 - 2016, periudhë gjatë së cilës kjo pronë është poseduar.*
- ix) *Mungesë burimesh financiare të ligjshme në periudhën 1992 - 2003, në shumën prej 2.727.865 lekësh, si dhe përgjatë periudhës 2004 - 2016, rezultojnë me bilanc negativ 4 vite, –përkatësisht 2004, 2005, 2008, 2009, – përgjatë të cilave rezulton një mungesë burimesh financiare të ligjshme, në shumën prej 4.427.471 lekësh.*
- x) *Nga analiza financiare për periudhën 1992 - 2016 rezulton se të ardhurat e ligjshme të realizuara nga subjekti i rivlerësimit nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar blerjet e pasurive të paluajtshme, kursimet, pra gjendjen e likuiditeteve në bankë dhe*

cash në shtëpi, si dhe për të kryer shpenzimet jetike dhe ato të deklaruara.

b- në lidhje me kontrollin e figurës:

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo me vërtetësi. Nga analiza e të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38, i ligjit nr. 84/2016, dhe kryesisht bazuar në raportin e DSIK-së, rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe mund të vihet nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë konkludohet se ai është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës;

c- në lidhje me vlerësimin e atësive profesionale:

Rezultoi se, pavarësisht vlerësimit pozitiv të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, subjekti i rivlerësimit, – në sajë të problemeve me etikën; të mosdorëheqjes së tij nga gjykimi i çështjes ku njëra nga palët ishte formalisht dhuruese ndaj tij; të konstatimit të papërshtatshmërisë së tij me detyrën e gjyqtarit; të deklarameve të pavërteta, të pamjaftueshme dhe fiktive, – ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.

Arrin në përfundimin se:

- a- Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse, referuar pikës 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe parashikimeve të nenit D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës.**
- b- Lidhur me kriterin e figurës, subjekti i rivlerësimit, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, nenit 38 dhe pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të konkluzionit të organeve ligjzbatuese rezulton i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, dhe nuk ka dhënë shpjegime apo prova bindëse për të kundërtën.**
- c- Lidhur me kriterin e rivlerësimit profesional rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.**

Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.

Në këto kushte, Komisioni bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme arrin në konkluzionin që subjektit të rivlerësimit, z. Admir Thanza, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D, pikat 1, 3, 5 dhe nenin DH, pikat 3 e 4, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c” dhe pikave 2, 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Admir Thanza, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 17.07.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Olsi Komici
Kryesues

Lulzim Hamitaj
Relator

Brunilda Bekteshi
Anëtar

Sekretare gjyqësore

Denisa Kosta